Datë 28.03.2025 Prot.35 (tridhjetëepesë)

Protokoll nr. 35

I mbajtur sot më datë 28.03.2025, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.02.2025
4.P-V " Për bashkëpunimin ndërmjet Bashkisë Ferrara-Itali dhe Bashkisë Maliq";
5. P-V''Për rishpërndarjen e buxhetit shtesë të Bashkisë Maliq për vitin 2025''
6.P-V "Për dhënie ndihme financiare nga fondi social";
7.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.J.M banues në Fshat.Maliq, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies të zjarrit";
8.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Ronaldo Skënderi; Marainathi Avrami; Idlir Limllari; Rovena Terolli; Pranvera Begolli; Gentiana Drabo; Eriseld Jonusllari; Petrit Kupe; Fevri Sherifi; Enida Avdolli; Ilia Xhuti; Klea Baçi; Albina Xhejo; Server Xhuti; Yllson Ibrahimllari; Faslli Zholi; Lulëzim Hoxhaj; 19(nëntëmbëdhjetë) këshilltarë.

Mungesa: Floreta Zaçe; Xhuana Hoxhallari; Plator Çollaku; Aramando Dautllari; Danjela Ibrahim; Eglantina Balli; Marjeta Xhelollari; Andonaq Risto; Dalina Krekas; Almir Elezi; Neresida Shindo; 11 (njëmbëedhjetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë:z.Gëzim Topçiu; Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka; Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti;

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve! Të nderuar kolegë Këshilltarë, i nderuar Kryetari i bashkisë, të nderuar pjesmarës, fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të Bashkisë Maliq, ashtu sikur jeni njoftuar, ndërkohë materialet e mbledhjes i keni marrë parapakisht disa ditë më

parë, jemi në rregull me këtë pjesë, verifikojmë kurumin, korumi realizohet, sepese janë 19 Këshilltarë në sallë, mund të vijojmë me mbledhjen.Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës.

Kush është dakord me rendin e ditës? Por këtu doja të shtonim diçka, përgjegjsja e e Shërbimit Social ka sjellë një material shtesë, që ja u ka shpërndarë, te pika e ndihmës financiare jenë bërë ndryshime, një na personat që është në listë ka ndruar jetë dhe po zvëndësojmë me një të moshuar tjetër dhe një P-V tjetër është për disa nxënës në NJ.A Gorë që përfitojnë bursë nga fondet e bashkisë, është një problem që është ngritur në një mbledhje të kaluar dhe bashkia e sjellë si material, kemi dhe një P-V për shpenzime varrimi për personin që ka ndruar jetë, që ishte në P-V e Ndihmës Financiare, do doja ti shtoheshin rendit të ditës.A jeni dakord?
Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota pro me shtesat, Faleminderit!Më lejoni tju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar, janë gjithësej 10 vendime me karakter normativ dhe 7 me karakter kolektiv.Ju ftoj të miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar.

Kush është dakord me protokollin e mbledhjes së kaluar? 19 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota.Miratohet.Faleminderit! Dua tju kujtoj dhe konfliktin e interesit, nëse dikush nga ne ka konflikt interesi me pikat e rendit të ditës, nuk duhet të përfshihet në diskutime dhe në votim për atë pikë. Faleminderit! Kalojmë te pika e parë e rendit të ditës, P-V " Për bashkëpunimin ndërmjet Bashkisë Ferrara-Itali dhe Bashkisë Maliq";
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Kemi kohë që punojmë për këtë bashkpunim, si pjesë e projekteve të përbashkëta si vende të BE, duke aplikuar në projekete mundësi është më e madhe për tu shpallur fitues dhe pas disa muajsh negociata kemi arritur, që Kryetari i Bashkisë Ferrara na ka dërguar një kërkesë, ku kërkon që ne të bëjmë jë vizitë atje, të kemi bashkëpunime në fusha të ndryshme dhe të përcaktojmë mënyrën që programi ti përgjigjet nevojave tona.Po ju lexoj dhe ftesën që e ken bashkangjitur.Mbas këtij momenti ne i kemi kthyer një përgjigje, ku në parim kemi rënë dakord në parmn për bashkëpunimin, por kemi sqaruar që procedura ligjore kërkon të kalojë si fillim në Këshillin e Bashkisë, të njoftojmë për bashkëpunimin Ministrinë për Europën dhe punët e Jashtme, këtë njoftim e kemi bërë dhe presim vendimarrjen e këtij Këshilli që bie dakord për këtë bashkëpunim për hapat e mëtejshëm, pasi ajo do shkojë dhe për konfirmim dhe në Institucionin e Prefektit të Qarkut Korçë dhe momnetin kur ne kemi një kontratë bashkëpunimi mes palësh, ja bëjmë të njohur dhe Prefektit dhe Këshillit Bashkiak për hapat që do ndjekim dhe për atë çfarë duhet të arrijmë.Kjo është telegrafisht me pak fjalë, pastaj procedura të tjera që kanë të bëjnë me efekte financiare, ato që kanë të bëjnë me lëvizjet apo me pritjet e grupit të bashkisë Ferrara në Shqipëri do i diskutojmë rast pas rasti me Këshillin e Bashkisë, jam në këtë pikë, dua tju bëj me dije dhe bashkëpunimin që kemi patur me bashkinë në SHBA, viztia e tyre do jete pas zgjedhjeve, sepse nuk duam të jetë pjesë e efekteve elektorale, kemi rënë dakord që ajo të jetë pas 11 Majit të jetë vizita e tyre në bashkinë Maliq.Shumë faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar! Kemi diçka këtu?

Ylson Ibrahimllari:Përshëndetje! Në parim ne si grup opozitar e quajmë të vlefshme këtë formë bashkëpunimi por, e para e punës do donim tëdinim nëse Komisioni për Marrëdhënjet me Jashtë dhe Integrimin Europian është shprehur për këtë marrveshje apo jo? Në djeninë time ky Komision nuk është mbledhur, pavarsisht lajmërimit tuaj dhe unë gjej vend, ti jemi pak më rigorozë do doja të shkonim drejt një vendimi si Këshill Bashkiak, që Këshilltarët të normohen, në kuptimin figurativ për sa i përket pjesës të shpërblimit në ditët që mungojnë, të gjenden modalitet ligjore, se si do tarifohet ajo mungesa, sepse pjesmarja, kontributi për komunitetin, i cili ka votuar, besoj se do sihte një detyrim ardhja këtu, mos pjesmarja në Komisione, mos ardhja në mbledhje të Këshillit Bashkiak.Unë besoj se ne kemi një mundësi, në bazë të nenit 116 të rregullores të Këshillit, të nzjerim një vendim, në të cilin do themi:50% e kanë të dizbursuar pjesën e pagesës nga zgjedhja, 20% i kanë nga pjesamrja në Komision dhe 30 5 i kanë nga punët që bëjnë në lidhje me komunitetin, spepse kështu besoj që nuk vazhdohet më, kemi dy vjet që kemi mbledhur Këshillin Bashkiak, jemi konstituar në datë 19.06.2023 dhe këtu prezenca sa vjen edhe çedon e çedon, në një mënyrë sikur dikush i ka marrë me zor, shkojmë te Komisioni i Mandateve dhe Rregulloreve, i propozjomë Këshillit një vendim si të tarifohen, ose heqeim të gjithë dorë nga pagesa, le të jetë vullnetare dhe cili të dojë të vijë dhe cili jo.Por të vish në mbledhje dhe mezi të miratosh një Ndihmë Financiare, këtu jemi Avokatët më të paguar, Avokati më i mirë nuk merr më shumë se 30.000 lekë në orë, ne për 1 orë mbeldhje marrim 26.000 lekë dhe çuditem si nuk vijnë të na kapim për "Xhakete", mos e kethejmë në kaq qesharake, ju kam sjellë listën e Komisioneve të reja, ashtu si ne kemi menduar për ti bërë më të mira, të sillet dhe zvëndësuesja e znj.Rudina dhe ti miratojmë ato, më thoni ju z.Kupe cili është nën/Kryetari i Komisionit që drejton ti? Është zgjedhur? Jo.Pranvera kë ke nën/kryetar te Komisioni i Mandateve? Lidhur me bashkpunimin me bashkinë Ferrara Itali, kam një dhurtë për Kryetarin e Bashkisë Maliq dhe atë Ferrara, nga Fondacioni Shqipëtar i Papa Klemintit, "Urdhri Klementi XI-Albani" i jepet Kryetarit të Bashkisë Maliq dhe Kryetarit të Bashkisë Ferrara.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ju falenderoj shumë për vlersimin.

Ornildi Demollari: Faleminderit!Kemi diçka tjetër këtu?
Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota, Faleminderit!Me kërkesën që në një mbledhje tjetër, të kemi një informacion sa më të detajuar.Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V''Për rishpërndarjen e buxhetit shtesë të Bashkisë Maliq për vitin 2025'' ; Kemi disa shifra që rishpërndahen, nga buxheti i vitit 2025.Kush e do fjalën ?

Petrit Kupe: Ky P-V mendoj se, i shërben funksionimit të Agjencisë Mbështetëse, këto fonde janë pakësuar nga buxheti i bashkisë qendër dhe i janë drejtuar Agjencisë përkatëse, kuptohet kjo Agjenci ka nevojë për mbështetje dhe kjo është një shprehje e asaj, sepse Agjencia sa është krijuar dhe ka mungësë të theksuar funksionimi.Nuk kemi gjë tjetër, të miratohet P-V.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Ky fond ka qenë në buxhet, vetëm është bërë ndryshimi nga bashkia te Agjencia dhe nuk lëvizje tjetër.Këto fonde janë miratuar nga ana e Këshillit të

Bashkisë, por për efekt menaxhimi i kanë kalaur Agjencisë, janë zëra që ata do i përdorin dhe, normalisht ata duhet të mbajnë dhe përgjegjsinë dhe efektivitetin për çdo gjë.

Pranvera Begolli: Fondi për veshje popullore, ka kalaur për Open Cinema.

Ornildi Demollari: Faleminderit!Kemi diçka tjetër këtu? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?19 vota pro.

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 19 vota, Faleminderit! Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës, P-V "Për dhënie ndihme financiare nga fondi social"; Te ky P-V janë bërë disa ndryshime, në fillim kur u ndanë materialet ishin dy emra, ndërkohë gjatë këtyre ditëve njëri prej tyre nga ndruar jetë dhe është zvëndësaur me një emër tjetër.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Nuk e di rastin dhe kush ka ndruar jetë, por mendoj që këto lekë që ne kemi parshikaur ti kalojnë familjes për shpenzime varrimi.

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Nuk ka femiljar, ishte person i vetmuar, që ne e trajtonim nga fondi social.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Kush i mbulon shpenzimet e varrimit?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Për këtë kemi një P-V tjetër që kemi paraqitur.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në rregull.

Ornildi Demollari:P-V "Për dhënie ndihme financiare nga fondi social, Ermanda ke diçka këtu?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Është ajo që thamë pak më parë, duke qenë se një nga përfituesit e projekti ka ndruar jetë, e kemi zvëndësuar me një emër tjetër, që ka nevojë për mbështetje.

Ornildi Demollari: Cili nga këta ka ndruar jetë?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Z.Neim ka ndruar jetë dhe përfiton znj.Çelnike Bakollari.

Ornildi Demollari: Besoj se është e qartë kolegë, ka diçka tjetër këtu?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Nuk mund të trajtohet familja që thotë znj.Vera, sepse është në pritje të vendimit nga Komsioni dhe këto janë fonde të projektit nga fondi social.Nëse do i trajtojmë rastet, do i trajtojmë pas zgjedhjeve, duke qenë se nuk lejohet.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Tju shpjegoj diçka, duhet të jemi shumë të vëmendshëm në këtë moment, këtë muaj se periudhë elektorale dhe ne nuk duam të bëhemi pjesë e debateve për këtë punë.

Ornildi Demollari: Duhet të presim të kalojë periudha zgjedhore.

Pranvera Begolli: Familja në fjalë nuk ka asnjë të ardhur.

Ornildi Demollari: Familja është ndihmuar me paketa higjenike dhe ndihma ushqimore.

Yllson Ibrahimllari: Familjari thotë që kam kërkaur dhe dru zjarri dhe nuk më është dhënë, por gjendja e tij ka nevojë vërtet për mbështetjem tonë, sepse është një zonjë e paralizuar dhe qëndron pranë saj për ti shërbyer.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë do isha dakord ta ndihmonim jashtë çdo procedure.

Yllson Ibrahimllari: Nuk ka shkleje në këtë rast, ai do vijë me status deri në qershor dhe ato lekë do i marri, unë them të gjejë mundësinë drejtoria ti japi një ndihmë tani të zgjidhet kjo situatë.

Petrit Kupe:Në këtë rast që jemi dakord, nuk ka pse të përdoret për efekt monitorimi.
Yllson Ibrahimllari: Ky është një rast me konsensus të plotë nga të dyja palët.Faleminderit!
Enida Avdolli: Jemi këtu te diskutimi i ndihmave financiare, kam një rast, që e kam përcjellë dhe te Komisioni i Shëndetësisë.
Yllson Ibrahimllari: Po e kemi dhënë konsensusin.
Enida Avdolli:Bëhet fjalë për një vjazë 26 vjet, me një kancer në mëlçi, në gradë të avancuar.Pasi kam diskutuar me zyrën e Ndihmës Ekonomike, diskutimi ishte që jemi në periudhë zgjedhore dhe sa lejohet, por rati është vërtet urgjent, sëmundja është e rëndë kërkon trajtim të menjëhershëm, familja nuk ka mundësi, Komisioni i Shëndetësisë, është njohur dhe me disa dokumenta mjekësorë të vajzës.
Yllson Ibrahimllari: Ne si Komisioni i Shëndetësisë kemi dhënë konsensusin, e dyta është me metastaza empatike, të shtohet te lista.Ju faleminderit!
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Le ta kalojmë dhe këtë rast, ti japim një ndihmë finaniare prej 50.000 lekë, sepse nuk e di si është sitiata.Sekretari i Këshilli, ta shtojë në P-V bashkë me Drejtorinë e Shërbimit Social dhe ta rakordojë me Drejtorinë e Financës, të jemi në rregull.
Petrit Kupe: Doja të shtoja që këto raste janë vërtet të dhimbëshme, por ne nuk mund ti trajtojmë të gjithë rastet që vijnë në sallë, të kalojnë nga zyra.
Yllson Ibrahimllari:Në rastin konkret duke qënë mjek dhe duke patur dhe raste në familje me këtë sëmundje, unë besoj se aq sa jepim ne nuk i dalin për serumet, jo më për kimio terapi, unë besoj se këto dy raste e meritojnë të kalojnë.Ju falenderoj!
Ornildi Demollari: Me shpresën që tju vijmë pak në ndihmë.
Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Dua të sqaroj diçka, për këto dy raste duhet të bëhet P-V tjetër nga fondet e bashkisë.
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Drejtorinë e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës të përgatisin P-V dhe kanë dakortësinë e Këshillit.
Ornildi Demollari: Faleminderit!E kalojmë në votim pikën 6, bashkë me dy rastet e tjera?
Kush është dakord?19 vota pro.
Kundra? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet me 19 vota, Faleminderit miratohet dhe P-V "Për dhënie ndihme financiare nga fondet e bashkisë"; Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës, P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.J.M banues në Fshat.Maliq, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies të zjarrit"; Vlera financiare është 268.000 lekë.
Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Këto janë fonde të buxhetit të shtetit që Këshilli i ka miratuar në buxhet, për efekt të rënies të zjarrit gjatë vitit buxheto, për çdo rast Këshilli shprehet me vendimarrje sipas që ndodh në realitet.Ky rast është në F.Maliq, Komisioni ka vlersuar situatën dhe ka përgatitur dokumentacionin dhe preventivat dhe vlera shkon në 268.000 lekë, jemi brenda kuadrit ligjor të përcaktuar.
Ornildi Demollari: Faleminderit!Kemi diçka tjetër këtu? Po.
Yllson Ibrahimllari:Për të ndihmuar pak, shikoj këtu vërtetim zjarri, të pakëtën nga aq sa kemi lexuar, mund të shkruhet vërtetim i konstatimit të rënies të zjarrit.Janë materiale që ngelen në

Arkiva, të tregojmë më pak kujdes, kemi Juristë ti ndihmojnë pak në hartimin e shkresave.Vërtetim zjarri nuk e kam dëgjuar as në konceptin Letrar dhe as atë Juridik.

Ornildi Demollari: Faleminderit për konstatimin!

Yllson Ibrahimllari: Jo ishte sygjerim.

Ornildi Demollari: Faleminderit!Kemi diçka tjetër këtu? E kalojmë në votim?

Kush është dakord?19 vota pro.

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 19 vota, Faleminderit miratohet dhe pika 7 e rendit të ditës. Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V "Për shpenzime varrimi", është ajo që diskutuam pak më parë.

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Te P-V i parë ishin dy emra që përfitonin nga projekti për ndihmë shërbim mjeksor, duke qenë se njëri nga personat ndroj jetë, nga fondi i bashkisë mbulojmë shpenzimet e varrimit, ndërsa nga Fondi Social i përfituesve për të mushuar ne kemi shtuar një person tjetër në listë.Shpenzimet e varrimit mbulohen nga fondet bashkisë dhe kalojnë për subjketin që bëri shpenzimet e varrimit.

Ornildi Demollari:P-V "Për shpenzime varrimi" kanë nevojë për votim në Këshill?

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Po patjetër, është njëjti person.

Ornildi Demollari:P-V "Për shpenzime varrimi" në vlerën 40.000 lekë.

Kush është dakord?19 vota pro.

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 19 vota, Faleminderit!P-V i fundit "Për ndarjen e planit të bursave nga fondi i bashkisë për vitin shkollor 2024-2025" Bëhet fjalë për atë që diskutum në fillim, bëhet fjalë për disa nxënës në NJ.A Gorë, e kemi diskutar dhe në një mbledhje më parë, për problemin e shpenzimeve të transportit.

Yllson Ibrahimllari: Po është diskutar dhe mbledhjen e kalaur dhe është ngritur nga ana ime në mbledhjen e radhës të kaluar për disa nxënës të fshatit Mesmal dhe Strelcë.Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Atëherë janë gjashtë nxënës.

Kush është dakord?19 vota pro.

Kundra? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 19 vota, Faleminderit!Këto ishin pikat dhe tani kalojmë te diskutime të tjera, nëse keni diçka?

Faslli Zholi:Përshëndetje të gjithve!Në këto të ndryshme mendoj ta fillojmë për Kryetarin e fshatit që ndroj jetë, Fehmi Xhango.E kam përsëri te infrastruktura, te shërbimet, shikoj që kemi shumë mangësira, në kuadër të votimeve, në emër të subjektit që përfaqësoj që të bëjë kujdes dhe Administrata që mos përfshihen në orar të punës.Kemi varrezat e fshatit Libonik pa ujë dhe në fshatin Rov rruga e varrezave duhet të ishte bërë, kam kërkar dhe disa gjëra të tjera për Libonikun.

Petrit Kupe: Kam dhe unë një shqetësim që është krijuar ditët e fundit në NJ.A Libonik, një firmë, po bën zvëndësimin e rrjetit të ujit të pijshëm, që ka qenë i ri dhe po zvëndësojnë përsëri! Për mendimin tim nuk ishte e domzdoshme, ata kanë dëmtuar rrugët për shkak të punimeve

rrugët janë bërë të paklueshme, kam biseduar me ata që po bëjnë punimet dhe projekti nuk parashikon as 1 m kub çakëllim pas punimeve, duhet të zgjidhet.Faleminderit!

Server Xhuti:Për ujësjellsin e Zvezdës, Kryetari na tha në muajin Nëntor do përfundojë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ujësjellsi i Zvezdës, është në proces tenderimi, po bëhet vlersimi i firmave të shpresojmë të fillojë dita ditës.

Idlir Limllari: Dhe unë kisha diçka për pastrimet që bënë në Plasë dhe Zëmblak, doja tju përgëzoja, por kanë filluar njerzit hedhin përsëri mbeturina atje ku keni pastruar ju.Policia Bashkiake të vendosë gjoba, që të ndërgjegjsohen ose të vendosen tabela.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:I morra si shqetësime dhe patjetër që do i ndjek.Ujin në varrezat e Libonikut, rruga e Rovit, nuk ishte në gjendje që ne do dëshironim, e çakëlluar, mirë do ishte të ishte me asfalt, por jemi duke e parë.Rrjetin e ujit që tha Petriti e kemi problem në disa fshatra.

Albina Xhejo: Kur do jetë e mundur të bëhet ujësjellsi i fshatit Zvirinë? Ose të pastrohet çezmat e fshatit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kanë ardhur ekspertet dhe nuk po na jep rezultat, ne po shikojmë mundësinë të ndërpresim ujin që merr Vreshtasi dhe të furnizohet Zvirina, po gjejmë dhe dy zgjidhje të tjera një në Kopole që tani del jashtë funksonit, me ndërtimin e ujësjellist të ri të Podgories, do reabilitohet dhe depoja e Vreshtasit, do i japim ujë dhe nga Podgoria sepse uji është në sasi më të madhe.Pusi që pastruam në Zvirinë nuk na dha rezualtat, jemi duke diskutuar me ujësjellsin e Korçës për një zgjidhje.Për shqetësimin që u ngtit me ndërtimin e disa ujësjellsave që po bën ujësjellsi i Korçës dhe na ka prishur rrugët dhe rreshjet e ditëve të fundit ka krijuar një situatë jo normale, ne kemi rregaur menjëherë dhe ata janë duke marrë një zgjidhje.Plasë-Zëmblak do më vijë keq nëse hidhen mbetje, kemi bërë një investim shumë të madh, po mendojmë që rrugën anësore të Plasës ta ndriçojmë dhe të shkojmë drejt asfaltimit për ta kthyer në një zonë të bukur, do shikohet dhe nga ana jonë kjo problematikë.

Yllson Ibrahimllari:Në këtë pikë do shtoja dhe diçka, pas investimit që keni bërë duhet të bëni dhe një njoftim te mediat lokale për kundravajtjet administrative, besoj se do vlente në atë pjesë, sepse është goxha investim duhet rruajtur, një pronocim te Tv lokal i Korçës, njoftim për banorët e zonës, të cilët në bazë të nenit përaktës do marrin gjobë.Kam dhe diçka për sa i përket fshatit Mesmal pavarshisht popullsisë që është në reduktim, ata kanë probleme me ujësjellsin kërkojnë si markuça, është një terren i vështirë, ndoshta duhet parë mundësia te banderat që ka vetë Bordi i Kullimit, të cilat shpesh herë i keni përdorur në këtë formë.Ju faleminderit!

Ornildi Demollari: Kemi dhe një qyetar që ka një problem.

Qyetari: Kam problemin e djalit që e kam invalid në shtëpi, ja kanë ndërperë ndihma ushqimore, nga Doraksi.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Dorkasi nuk varet nga bashkia, por do e shohim si rast, nëse ke diçka me bashkinë na i thuaj, ja ku është Ermanda për ta zgjidhur.Dorkasi vepron vetë, ne i çojmë propozimet, për rastin në fjalë do e pyesim si qëndron, me shpresëta futin përsëri te paketa shtu si ka qenë.

Qyetari:nuk i njihet zonjës kujdestari si vite për pension?

Yllson Ibrahimllari: Familjarët që kanë raste të tilla, kërkojnë nga Shërbimi Social, pakëtën që marrin dhe lekët që marrin për shërbimin që bëjnë karshi personave me afatësi të kufizuar, thonë, pse nuk na quet en vjetërsi? Tju njihen si vite pune.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Mund ta sygjerojmë.

Yllson Ibrahimllari: Mund ta sygjerojmë, mund ta diskutojmë, ne do marrim masa qoftë me Fondacionin në fjalë, qoftë me Fondacion tjetër, zotëria do marri përgjigje në mbledhjen e radhës.Unë dhe Doktoresha jemi dakord, sepese fëmijët e tij i plotësojnë konditatat për ti patur nga ana Socio-Shëndetësore, brenda kuadrit ligjor.

Ornildi Demollari: Faleminderit! Kjo ishte mbeldhja për sot.Ditë të mbarë.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI